

VENDIM
Nr. 282, datë 4.5.2023

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 422, DATË 6.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT E FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN FINANCIAR TË GRUPIT NEGOCIATOR DHE DETYRAT E KRYENEGOCIATORIT PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, të vendimit nr. 749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të kreut I, të vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në nënndarjen “- Z. Besfort Lamallari, zëvendësministër i Brendshëm, dhe z. Julian Hodaj, zëvendësministër i Brendshëm, bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 24”, fjalët “... dhe z. Julian Hodaj, zëvendësministër i Brendshëm, bashkënegociator përgjegjës ...” zëvendësohen me “... negociator përgjegjës ...”;

b) Nëndarja “- Znj. Adela Xhemali, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kriterin ekonomik dhe kapitujt 4, 32 dhe 33” zëvendësohet me “- Znj. Adela Xhemali, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kriterin ekonomik, kapitujt 32 dhe 33”;

c) Nëndarja “- Z. Besart Kadia, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kapitujt 1, 2, 3, 6, 7, 20 dhe 30, si dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitujt 19 e 28” zëvendësohet me “- Z. Endrit Yzeiraj, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kapitujt 1, 3, 6, 7, 20 dhe 30, si dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 4 dhe 28.”;

ç) Fjalët “Znj. Ermira Gjeçi ...” zëvendësohen me “Z. Arian Jaupllari ...”;

d) Fjalët “Znj. Ornela Çuçi ...” zëvendësohen me “Znj. Almira Xhembulla ...”;

e) Në fund të nënndarjes “- Znj. Natasha Ahmetaj, zëvendësguvernator i dytë në Bankën e Shqipërisë, negociator përgjegjës për kapitullin 17”, shtohen fjalët “... dhe bashkënegociator për kapitullin 4”;

f) Në fund shtohet nënndarja “- Znj. Olta Manjani, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kapitullin 2, si dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 19”;

2. Ngarkohen ministri i Shtetit dhe Kryenegociator dhe grupi negociator për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku